VENDIM
Nr.33, datë 11.5.2011

PËR NJË SHTESË NË RREGULLOREN "PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe të nenit 43 shkronja "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr.14, datë 11.3.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, pas paragrafit të parë të nenit 3, të shtohet paragrafi me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

"Përveç veprimtarive të parashikuara në nenin 54 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", bankat dhe degët e bankave të huaja lejohen të kryejnë veprimtarinë e shërbimit të kasave të sigurimit, pas licencimit ose dhënies së miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarisë shtesë nga Banka e Shqipërisë, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Ibrahimi